

# FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE TË MOLDAVISË

Korniza juridike dhe masat për  
pjesëmarrje gjithëpërfshirëse



Implementuar nga



International Foundation  
for Electoral Systems

Janar 2025



# TABELA E PËRMBAJTJES

**1**  
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**2**  
HYRJE

**3**  
KORNIZA JURIDIKE DHE RREGULLUESE PËR FINANCIMIN  
E PARTIVE POLITIKE NË MOLDAVI

**4**  
BURIMET E LEJUESHME TË FINANCIMIT PËR  
PARTITË POLITIKE

Ndarjet e buxhetit të shtetit

---

Tarifat e anëtarësimit të partive politike

---

Donacionet për partitë politike

---

Prurjet e tjera të përfituara ligjërisht

---

Konsideratat lidhur me përdorimin e burimeve  
publike të financimit për PP

## **KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE MASAT E TRANSPARENCËS**

Institucionet përgjegjëse dhe organet mbikëqyrëse

---

Konsideratat lidhur me zgjedhjet/me financat e  
fushatave zgjedhore dhe raportimin

## **MASAT E NXITJES SË PJESËMARRJES SË GRAVE DHE TË RINISË NË POLITIKË**

Konsideratat lidhur me ndikimin e masave ligjore për nxitjen e  
pjesëmarrjes së grave dhe rinisë në politikë

Konsideratat lidhur me respektimin e kërkesave ligjore për  
ndarjen e fondeve për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe rinisë.

## **SFIDAT KRYESORE NË FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE**

### **SHTOJCAT**

#1 Fjalorthi

---

#2 Korniza të hollësishme ligjore dhe rregulluese për  
financimin e PP në Moldavi

---

#3 Referencat

# 1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky punim shqyrton kornizën juridike dhe masat për financimin e partive politike në Moldavi, me fokus të veçantë në nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe rinisë në politikë. Ofron informacion për burimet e lejueshme të financimit, bën fjalë për kërkesat e raportimit, institucionet përgjegjëse dhe organet mbikëqyrëse. Përveç kësaj, bën përkrahimin e vështirësive kryesore rreth financimit politik të partive.

Partitë politike moldave financohen përmes modelit të kombinuar që përfshin ndarjet e buxhetit shtetëror, tarifat e anëtarësimit, donacionet dhe prurjet e tjera ligjore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) mbikëqyr ndarjen e fondeve shtetërore, të cilat shpërndahen bazuar në rezultatin e zgjedhjeve dhe promovimin e grave dhe rinisë në politikë. Përkundër rregulloreve të rrepta për përdorimin e këtyre fondeve, varësia gjithnjë e më e madhe tek ndarja e fondeve shtetërore —që arrijnë deri në 84% të prurjeve partiake – ngre shqetësime.

Për të siguruar llogaridhënie në menaxhimin e tyre financiar, partitë duhet t'ia dorëzojnë raportet financiare KQZ-së dy herë në vit, së bashku me raportet mujore dhe vjetore shtesë. Këto raporte, të cilat përfshijnë deklaratat bankare mujore dhe regjistrimet e prurjeve dhe shpenzimeve, parashtrihen në mënyrë elektronike përmes sistemit të "Kontrollit financiar" dhe bëhen të qasshme publikisht brenda 48 orëve nga pranimi. Për të përmirësuar mbikëqyrjen, KQZ-ja bashkëpunon me Gjykatën e Llogarive dhe subjektet tjera, duke caktuar dënime të rënda për mospërfshirje, duke përfshirë ndalimet e përkohshme të aktiviteteve politike.

Korniza aktuale është e krijuar për të mbështetur transparencën, për të mbrojtur besimin e publikut dhe për të ruajtur integritetin e financimit politik në Moldavi.

Ky punim, gjithashtu, bën fjalë për masat juridike në Moldavi, të cilat nxisin pjesëmarrjen e grave dhe rinisë në politikë. Legjislacioni kryesor përfshin Ligjin për sigurimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave dhe Ligjin për partitë politike, që urdhërojnë zbatimin e kuotave gjinore, kërkesat e reduktimit të nënshkrimeve për kandidatet gra dhe stimujt financiarë për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe rinisë. Thekson ndikimin pozitiv të këtyre masave, veçanërisht përfaqësimin e rritur të grave dhe rinisë në Parlamentin e Moldavisë. Më tej, merret me çështjen e përputhjes së partive politike me kërkesat ligjore për ndarjen e fondeve që të promovohet barazia gjinore dhe angazhimi rinor, duke vënë në dukje sfidat në zbatim dhe duke ofruar rekomandime për forcimin e besnikërisë.

Edhe pse Moldavia ka shënuar progres në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes përmes ndarjeve të fondeve shtetërore, kërkesave të rrepta për raportim dhe masave për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave dhe rinisë, megjithatë disa vështirësi kanë mbetur ende, duke përfshirë përputhjen me rregulloret financiare, mbështetjen gjithnjë e më të madhe të partive politike në financimin shtetëror, ndërhyrjen e huaj dhe zbatimin efektiv të masave afirmative.

## 2 HYRJE

Ky punim hulumton kornizën juridike të Moldavisë me të cilën rregullohet financimi i partive politike, duke u përqendruar në masat që të nxitet pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në politikë. Shqyrton institucionet dhe mekanizmat përgjegjës për mbikëqyrjen e financave të partive, nënvizon burimet e financimit për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe vlerëson efektivitetin e masave afirmative në praktikë. Analiza, gjithashtu, jep një pasqyrë të ndryshimeve historike të këtyre dispozitave, duke ofruar vështrime për ndikimin e tyre në peizazhin politik të Moldavisë. Momentalisht, korniza juridike nuk përfshin dispozita specifike, që kanë për synim grupet e tjera të rrezikuara.

Financimi i partive politike është shtyllë themelore e demokracisë, që ndikon drejtpërdrejtë në funksionimin e duhur të saj në shoqërinë moldave. Ekzistenca e partive politike lidhet në mënyrë të natyrshme me burimet financiare, ndërsa zhvillimi i çdo fushate zgjedhore do të ishte i pamundur pa ndonjë burim financimi, qoftë publik, privat ose i kombinuar. Dispozitat ligjore lidhur me financimin e partive politike synojnë të sigurojnë konkurrencë të ndershme, transparencë dhe llogaridhënie.

Një faktor kyç në ndërtimin e besimit të votuesve është disiplina financiare e partive politike, e cila është thelbësore që të sigurohet konkurrenca e ndershme, transparenca dhe llogaridhënia në procesin demokratik, siç është hulumtuar në këtë punim.

## 3 KORNIZA JURIDIKE DHE RREGULLUESE PËR FINANÇIMIN E PARTIVE POLITIKE NË MOLDAVI

Korniza juridike që rregullon financimin e partive politike në Moldavi është krijuar përmes ligjeve dhe rregulloreve kryesore, duke përfshirë Kodin Zgjedhor, (nr. 325/2022), Ligjin për Partitë Politike (nr. 294/2007), Kodin Kundërvajtës (nr. 218/2008), Kodin Penal (nr. 985/2002) dhe rregulloret e miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Këto ligje në mënyrë kolektive theksojnë transparencën, llogaridhënien dhe menaxhimin e duhur të financave të partive, duke vendosur rregullat e mbështetjes shtetërore, ndalimet për llojet e caktuara të financimit, si dhe ndëshkimet për shkeljet. Për dispozitat e hollësishme dhe mekanizmat zbatues, shih Shtojcën 2.

# 4

## BURIMET E LEJUESHME TË FINANCIIMIT PËR PARTITË POLITIKE

Burimet e financimit për një parti politike mund të përfshijnë:

- Ndarjet e buxhetit të shtetit (Subvencionet shtetërore)
- Tarifat e anëtarësimit të partive
- Donacionet
- Prurjet e tjera të përfituara ligjërisht

Partitë politike nuk lejohet që të përdorin burime të tjera financimi përveç atyre të lartpërmendurave


### NDARJET E BUXHETIT SHETETËROR

Sipas dispozitave të nenit 27 të Ligjit nr. 294/2007 për partitë politike, partitë politike kanë të drejtë të pranojnë financim nga buxheti shtetëror përmes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në baza vjetore. E drejta e partive politike për të pranuar financim nga buxheti shtetëror u miratua nga Parlamenti i Republikës së Moldavisë më 9 prill, 2015, përmes Ligjit nr. 36/2015. Kështu ishte modifikuar sistemi i financimit të partive politike nga financimi ekskluzivisht privat në sistemin e kombinuar, ku fondet e buxhetit shtetëror plotësonin financimin privat. Rrjedhimisht, dispozitat që rregullonin ndarjet e buxhetit shtetëror gjetën përdorim te partitë e kualifikuara për herë të parë më 1 janar të vitit 2016. Kandidatët e pavarur, pa marrë parasysh llojit të zgjedhjeve apo postit zgjedhor për të cilin kandidohen, nuk pranojnë kurrfarë ndarje buxhetore.

Në bazë të Ligjit nr. 294/2007 për partitë politike, shuma e ndarjeve për financimin e partive politike është miratuar në ligjin për buxhetin vjetor, ku përqindja aktuale është 0.1% e prurjeve të buxhetit shtetëror, duke përfshirë prurjet për qëllime të veçanta të parapara nga legjislacioni dhe kjo ndarje bëhet në këtë mënyrë:

- ▶ 30% për Zgjedhjet parlamentare: Kjo pjesë u jepet partive politike bazuar në rezultatin e tyre në zgjedhjet e fundit parlamentare. Sa më shumë vota që merr një parti, aq më e madhe është pjesa e këtij 30%-shi.
- ▶ 30% për Zgjedhjet lokale: Ngjashëm me pjesën për zgjedhjet parlamentare, kjo pjesë ndahet bazuar në rezultatet e zgjedhjeve lokale. Nëse partia pranon më shumë vota në zgjedhjet lokale, merr një pjesë më të madhe të këtij 30%-shi.
- ▶ 15% për Zgjedhjet presidenciale: Kjo është dhënë në bazë të asaj se si partitë politike kanë rezultuar në zgjedhjet e fundit presidenciale, veçanërisht në bazë të votave të marra në rrethin e parë të zgjedhjeve. Rezultatet e rrethit të dytë nuk merren parasysh gjatë përlllogaritjes së shumës së ndarjeve.
- ▶ 7.5% për gratë e zgjedhura në Parlament: Kjo bazohet në numrin e grave të zgjedhura në parlament. Sa më shumë gra që do të zgjidhen nga një parti, aq më e madhe është pjesa e tyre nga ky 7.5%-ësh.
- ▶ 7.5% për gratë e zgjedhura në Zgjedhjet lokale: Kjo pjesë funksionon në mënyrën e njëjtë si paraparakja por përqendrohet në zgjedhjet lokale. Sa më shumë gra që ka zgjedhur një parti në nivelin lokal si kryetarë dhe këshilltare komunash, aq më shumë do të marrë nga ky 7.5%-ësh.

- ▶ 5% për të rinjtë e zgjedhur në Parlament: Me këtë përqindje shpërblehen partitë politike bazuar në numrin e të rinjve të zgjedhur (deri në moshën 35 vjeçare) në parlament.
- ▶ 5% për të rinjtë e zgjedhur në zgjedhjet lokale: Në mënyrë të ngjashme, kjo pjesë bazohet në numrin e të rinjve të zgjedhur në pozita të nivelit lokal – kryetarë dhe këshilltarë komunash.



Në praktikë, qeveria ndan mënjanë 0.1% nga buxheti i përgjithshëm kombëtar (duke përjashtuar fondet specifike). Së pari, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kalkulon shumën e përgjithshme në dispozicion për secilin kriter të lartpërmendur (si 30%, 7.5%, etj.). Më pas, KQZ-ja kalkulon sa para do të pranojë secila parti bazuar në atë se sa vota kanë marrë ato, sa gra ose sa të rinj kanë zgjedhur ato. Sa më shumë vota ose zyrtarë të zgjedhur kanë në këto kategori, aq më e madhe është pjesa e tyre në secilën pjesë të buxhetit.

Si për shembull, nëse buxheti i përgjithshëm për partitë politike është 40 milionë MDL[1], 7.5% e asaj shume (3 milionë Lei) do të kishin shkuar për numrin e grave të zgjedhura në parlament. Më tej, KQZ-ja i ndan këto 3 milionë lei, sipas numrit të përgjithshëm të grave të zgjedhura në parlament, për të përcaktuar sa para përfaqëson secila grua e zgjedhur. Pas kësaj, secila parti merr një pjesë, në bazë të numrit të grave që kanë zgjedhur.

Kjo metodë siguron se fondet janë duke u shpërndarë në mënyrë të drejtë, duke pasur parasysh faktin sa prezantohen cilësisht partitë në zgjedhje dhe si kontribuojnë në çështjen e barazisë gjinore dhe përfshirjes së rinisë në politikë.



Rregulloret që rregullojnë financimin e partive politike, përfshirë metodologjinë e përlllogaritjes, miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Çdo vit, pas miratimit të Ligjit për buxhetin e shtetit, Komisioni miraton shpërndarjen mujore për secilën parti politike për vitin gjegjës fiskal, duke përdorur metodën e përlllogaritjes të përshkruar më lart. Nëse zgjedhjet parlamentare, presidenciale ose lokale janë mbajtur gjatë vitit kalendarik, Komisioni mund t'i miratojë ose t'i rishikojë shumat e shpërndarjes mujore në bazë të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, duke nisur nga muaji rrjedhës i datës kur rezultatet janë konfirmuar nga ana e autoriteteve përkatëse

Në rastin e koalicioneve zgjedhore, ndarjet e buxhetit shtetëror do të bëhen në bazë të marrëveshjes paraprake ndërmjet anëtarëve të koalicionit zgjedhor. Nëse nuk ekziston marrëveshja, ndarja do të bëhet në bazë të numrit të mandateve të fituara nga secili anëtar i koalicionit. Ndarja bazohet në shpërndarjen origjinale të mandateve pas zgjedhjeve dhe nuk ndryshon nëse ndonjë deputet ndërron përkatësinë partiake gjatë mandatit.

Nëse një parti e humbet të drejtën e financimit shtetëror ose nëse kjo e drejtë suspendohet, transferimi i fondeve do të ndalet, duke filluar nga muaji pas humbjes ose suspendimit të së drejtës. Çdo fond i pashpenzuar, i transferuar në llogarinë e partisë politike brenda vitit aktual fiskal do të jetë në dispozicion për partinë që ta përdorë vitet vijuese.

Partitë politike humbin të drejtën e tyre e financimit shtetëror në rastet e mëposhtme:

- 01 Nëse veprimtaria e tyre është e limituar[1]
- 02 Nëse ato e humbin personalitetin e tyre juridik
- 03 Nëse ndodhen në fazën e likuidimit
- 04 Nëse janë sanksionuar me heqjen e të drejtave të tyre të financimit shtetëror.

[1] Neni 21 nga Ligji për partitë Politike nr.294/2007 rregullon rastet dhe metodat të kufizimit të veprimtarive të partive politike. Në këtë mënyrë, veprimtaritë partiake mund të kufizohen në rastet ku veprimet dëmtojnë pluralizmin politik ose parimet themelore demokratike. Vihen në përdorim kufizimet plotësuese nëse partia nuk ia del të dorëzojë raportin e tij financiar të menaxhimit ose të sigurojë informacion të domosdoshëm për mbikëqyrje financiare, siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në raste të këtylla, Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë nga kryesia partiake t'u japë drejtim çështjeve brenda një muaji. Nëse mosrespektimi i kësaj vazhdon, gjykata mund të vendosë një kufizim të veprimtarive partiake deri në gjashtë muaj. Gjatë kësaj periudhe, partisë i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje, organizimi i ngjarjeve publike ose angazhimi në reklamimin politik. Megjithatë, kufizimet nuk mund të zbatohen gjatë fushatave zgjedhore.

[https://www.legis.md/cautare/getResults?doc\\_id=141459&lang=ro#](https://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=141459&lang=ro#)

Një parti politike që i ka humbur të drejtat e saj të financimit shtetëror mund t'i rifitojë ato përmes vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi që shkaku i humbjes ose sanksioni nuk është në fuqi më.

Kur një parti politike riorganizohet[2], e drejta e financimit shtetëror i transferohet pasardhësit të saj. Nëse një parti politike që përfiton nga financimi shtetëror ndërpret veprimtarinë e saj, fondet që i takojnë asaj partie do t'u rindahen partive të tjera, të kualifikuara politike.

Përdorimi i ndarjeve shtetërore rregullohet më saktësisht me nenin 28 të Ligjit për Partitë Politike dhe vendoset nga organet qeverisëse të partive politike. Këto ndarje buxhetore mund të përdoren, duke përfshirë mbështetjen e grupeve iniciative të regjistruara nga partia politike ose fushatat zgjedhore[3], ekskluzivisht për qëllimet e mëposhtme:

- ▶ Shpenzimet operative dhe administrative: qiraja, mirëmbajtja dhe funksionimi i selive të partive; shpenzimet e personelit (rrogat); shpenzimet e protokollit, furnizimet e zyrës, tarifat bankare dhe shpenzimet e revizionit (të jashtme/të detyrueshme).
- ▶ Shtrirja, promovimi dhe angazhimi publik: media dhe materialet promovuese; prodhimi dhe transmetimi i spoteve reklamuese; organizimi i aktiviteteve politike, demonstratave publike, seminareve, kurseve trajnuese për anëtarët partiakë, programet për të rininë dhe gratë dhe sondazhet e opinionit publik në shkallë vendore dhe kombëtare.
- ▶ Shërbimet këshillëdhënëse dhe juridike: këshillimi politik; këshillimi juridik, tarifat e avokatit, shpenzimet e përmbaruesit dhe ekspertit; shërbimet gjyqësore dhe shpenzimet e tjera të institucioneve shtetërore.
- ▶ Udhëtimi dhe delegacionet: shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit; pritja e delegacioneve të huaja; shpenzimet e karburantit, transportit dhe udhëtimit.
- ▶ Teknologjia dhe menaxhimi i mjeteve pasurore: telekomunikacionet, aplikacionet e uebit, zhvillimi i ueb faqes së partisë dhe investimet në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme për veprimtaritë partiake.
- ▶ Anëtarësia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare: pagesa e anëtarësimit në organizatat politike ndërkombëtare.

---

[2] Në bazë të Ligjit për Partitë Politike, Nr.294/2007, një parti mund të riorganizohet përmes mënyrave të ndryshme, përfshirë bashkimin (kombimin ose shkrirjen), ndarjen ose transformimin, bazuar në vendimin e organeve të larta drejtuese. Trashëgimtari juridik i një partie politike përcaktohet në mënyrë tipike nga organet kryesuese të partisë, në përputhje me statutin e partisë. Në rastet e kundërthënieve të brendshme ose situatave komplekse, ndoshta do të jetë i nevojshëm vendimi i gjykatës për të zgjidhur çështjen e trashëgimitarit juridik.

[3] Partitë politike kanë të drejtën e përdorimit deri në 70% të shumave të ndara nga buxheti shtetëror që ndodhen në llogarinë e partisë në fillim të fushatës zgjedhore për fushatat e tyre zgjedhore, neni 51 paragrafi (10), Kodi Zgjedhor nr.325/2022

Nga shuma e përgjithshme e ndarjeve vjetore nga buxheti i shtetit, partia duhet të shfrytëzojë:

- ➔ 20% për promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së grave në proceset politike dhe zgjedhore.
- ➔ 10% për promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politike dhe zgjedhore.

Ndarjet e buxhetit të shtetit të përdorura për qëllime tjera nga ato të parashikuara me ligj, si dhe për mospërmbajtjen e proporcionit për promovimin dhe inkurajimin e grave dhe rinisë, duhet t'i kthehen buxhetit të shtetit në bazë të vendimit të Gjykatës së Llogarive, në sasinë e përdorur ndryshe nga synimi i pasur.

## **TARIFAT E ANËTARËSIMIT TË PARTIVE POLITIKE**

Shuma e tarifave të anëtarësimit, metoda e pagesës dhe frekuenca e pagesës përcaktohen nga partitë politike në statutet e tyre. Informacioni i komunikohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Tarifat e anëtarësimit mund të mblidhen me para të gatshme ose përmes operacioneve bankare. Kur mblidhet në para të gatshme, lëshohet fatura, ndërsa shuma transferohet në llogarinë bankare të partisë politike brenda 5 ditëve pune.

## **DONACIONET PËR PARTITË POLITIKE**

Një parti politike mund të pranojë donacione monetare[5] dhe jomonetare[6]. Të gjitha donacionet duhet të bëhen përmes operacioneve bankare (pagesat me kartelë, transferimet e drejtpërdrejta), me identitetin e donatorit të shënuar në dokumentin bankar. Donacionet në para të gatshme në zyrën e partisë, pa llogari bankare duhet të depozitohen në llogarinë bankare të partisë.

Prurjet vjetore të një partie politike nga donacionet dhe anëtarësimet nuk duhet të tejkalojnë 0.1% të prurjeve të përgjithshme të buxhetit shtetëror.

Donacionet e bëra nga individët për një apo më shumë parti politike në një vit fiskal nuk duhet të tejkalojnë ekuivalentin e pagave mesatare mujore[7] për vitin gjegjës. Ky kufi nuk duhet të tejkalojë 30% të prurjeve të tyre vjetore të regjistruara për kalendarin e mëparshëm vjetor. Qytetarët moldovas që marrin vetëm bursa ose përfitime tjera sociale, kufiri i donacionit nuk duhet të tejkalojë një pagë mesatare mujore për vitin gjegjës.

Për qytetarët moldovas që mbajnë poste publike, nëpunësit publikë, duke përfshirë ata me status special, ose të punësuarit në organizatat publike, shuma e donacionit nuk duhet të tejkalojë 10% të prurjeve të tyre vjetore dhe nuk duhet të tejkalojë gjashtë paga mesatare mujore për vitin gjegjës.

[5] Kontribute ndryshe nga tarifat e anëtarësimit, që rrjedhin nga punësimi, sipërmarrësia, veprimtaritë shkencore ose kreative, bursat, pensionet, përfitimet sociale (me përjashtim të ndihmës sociale) ose të ardhurat tjera ligjore të qytetarëve të Moldavisë.

[6] Kontributet në formën e pronave, të mirave, shërbimeve falas ose me zbritje, që janë regjistruar në llogarinë e partisë dhe janë vlerësuar me çmimin e tyre të tregut.

[7] Paga mesatare mujore miratohet nga Qeveria çdo vit. Për 2025, është vlerësuar në 16,100 lei (përafërsisht 840 euro).

Nëse individ është anëtar partiak, kufiri i përmendur përfshin shumën e tarifave të anëtarësimit që e paguajnë për një vjet, me ç'rast anëtarësimi dhe donacioni regjistrohen ndaras në raportet e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar të partisë.

Një individ mund të bëjë donacione me para të gatshme për një ose më shumë parti politike deri në vlerën e një page mesatare mujore për vitin gjegjës. Donacionet që tejkalojnë këtë kufi duhet të bëhen ekskluzivisht përmes operacioneve bankare.

Një subjekt juridik mund të japë donacion për një ose më shumë parti politike në një vit fiskal, por shuma e përgjithshme nuk duhet të tejkalojë ekuivalentin e 12 pagave mesatare mujore për vitin gjegjës.

Subjekti juridik që bën një operacion monetar për një parti politike duhet të paraqesë vendimin e organeve të tij të autorizuar lidhur me donacionin, të regjistrojë donacionin, ta pasqyrojë në raportet e tij financiare dhe t'i informojë aksionarët ose anëtarët e tij rreth transaksioneve të bëra.

Kohë më parë, një projekt-propozim ligj kërkon të kufizojë donacionet nga studentët, pranuesit e përfitimeve sociale dhe subjektet juridike në 30% të prurjeve të tyre të vitit të kaluar, duke siguruar që donacionet janë proporcionale me kapacitetin e tyre financiar.[8]

Donacionet nuk mund të bëhen nga:

- Të miturit dhe individët nën mbrojtjen ligjore.
- Qytetarët e huaj, personat pa shtetësi, donatorët anonim ose ata që japin donacione në emrin e të tjerëve.
- Autoritetet publike, organizatat e financuara nga shteti, ose sipërmarrjet në pronësi të shtetit, përveç kur kjo shprehimisht lejohet me ligj.
- Subjekte juridike me borxhe të pashlyera ndaj fondeve shtetërore ose personat e përfshirë në kontratat e furnizimit publik brenda tre viteve të fundit.
- Subjekte me kapital të huaj ose të kombinuar, subjektet e huaja juridike, dhe organizata ndërkombëtare ose jofitimprurëse.

Donacionet që tejkalojnë tri paga mesatare mujore të vendosura për vitin gjegjës janë objekt verifikimi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të siguruar deklaratën e burimeve të prurjeve dhe të gjitha detyrimet e ndërlidhura tatimore Nëse ka shqetësime në lidhje me respektimin e ligjeve tatimore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të kryejë kontrolle dhe, nëse është e nevojshme, do të marrë masa për t'i thirrur në përgjegjësi individët për shkelje administrative. Më tej, Komisioni mund të referojë çështjen te Shërbimi tatimor shtetëror për verifikim të mëtutjeshëm në kuadër të juridiksionit të tij.

[8] Vendimi i KQZ-së për pëlqimin e mendimit për ndryshimin e akteve të caktuara normative të projekt ligjit (lufta efektive e korrupsionit zgjedhor dhe aspektet përkatëse), nisma ligjore nr. 381 më 17 dhjetor, 2024, [https://a.cec.md/ro/pentru-aprobarea-avizului-asupra-proiectului-de-lege-pentru-modificarea-unor-2751\\_112136.html](https://a.cec.md/ro/pentru-aprobarea-avizului-asupra-proiectului-de-lege-pentru-modificarea-unor-2751_112136.html)

## **PRURJE TË TJERA TË PËRFITUARA ME LIGJ**

Partia politike ka të drejtë të angazhohet në veprimtari redaktuese, në veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me menaxhimin e pasurisë së saj, si dhe në veprimtari tjera që krijojnë të ardhura për nevojat e partisë, poqë se këto veprimtari nuk janë të ndaluara me ligj dhe përmenden shprehimisht në statutin e partisë.

## **KONSIDERATAT LIDHUR ME PËRDORIMIN E BURIMEVE PUBLIKE TË FINANCIMIT PËR PARTITË POLITIKE**

Vitet e fundit tregojnë se partitë politike në Republikën e Moldavisë janë bërë tejet të varura në ndarjet e buxhetit shtetëror për financimin e tyre[9]. Në vitin 2023, këto fonde publike përbënin 84% të shumës së përgjithshme të prurjeve të raportuara të partive politike, deri në 82% në vitin 2022. Një numër i konsiderueshëm i partive pothuajse mbështeten plotësisht në burimet shtetërore, me proporcione financimi afërsisht 100%[10].

Megjithatë, ka një variabilitet në këtë tendencë. Disa parti kanë pjesë më të vogla të financimit publik, me përqindje si 60%, 76%, 11%, dhe 9%. Kjo tregon se këto parti kanë arritur të sigurojnë burime tjera domethënëse të prurjeve, siç janë donacionet, tarifat e anëtarësisë, ose burime të ardhurash prej veprimtarive ekonomike.

Varësia e madhe në financimin publik ngre një sërë çështjesh të rëndësishme. Politikisht, kjo mbështetje mund t'i bëjë partitë më të ndjeshme ndaj ndikimit të qeverisë. Financiarisht, kjo nënvizon nevojën për një shumëllojshmëri më të madhe të burimeve të financimit për të forcuar autonominë e subjekteve politike.

Gjatë fushatave zgjedhore, partitë i shfrytëzojnë këto fonde shtetërore së bashku me kontributet private për t'i mbuluar shpenzimet e ndryshme, përfshirë organizimin e ngjarjeve, prodhimin e materialeve promovuese dhe mirëmbajtjen e ambienteve. Në bazë të nenit 51 të Kodit Zgjedhor, partitë politike mund të përdorin deri në 70 % të fondeve nga ndarja vjetore në llogarinë e partisë në fillimin e periudhës zgjedhore për fushatën e tyre zgjedhore. Përveç kësaj, mbështetja shtetërore për fushatat zgjedhore sigurohet ndër të tjera përmes transmetimit pa pagesë dhe kredive pa interes. Mbështetja në fondet shtetërore gjatë fushatave zgjedhore tregon variacione të konsiderueshme nëpër ngjarjet e ndryshme zgjedhore, duke pasqyruar strategji të ndryshme financimi ndërmjet partive politike dhe kandidatëve. Në zgjedhjet e përgjithshme lokale në vitin 2023, 14 prej 32 partive deklaruan se shfrytëzojnë fonde shtetërore, me përqindje që lëvizin prej 7% deri në 100%. Të dhënat e referendimit kushtetues të vitit 2024 tregojnë se në mesin e dhjetë partive që i kanë dorëzuar raportet financiare, katër prej tyre janë mbështetur në ndarjet shtetërore, me fondet publike që

[9]<https://epde.org/?news=political-party-funding-in-moldova-retrospective-2023-growing-dependence-on-state-budget-appropriations-and-unreported-expenditures>; [https://epde.org/wp-content/uploads/2024/07/Summary-report\\_Financing-of-political-parties-in-the-Republic-of-Moldova\\_2023-Retrospective.pdf](https://epde.org/wp-content/uploads/2024/07/Summary-report_Financing-of-political-parties-in-the-Republic-of-Moldova_2023-Retrospective.pdf)

[10]Bazuar në analizat e vendimit të KQZ-së nr. 2560, më 31 maj 2024, mbi dhënien e mbikëqyrjes së raporteve për menaxhim financiar të partive politike, për vitin 2023

përbëjnë 20%, 68%, 89%, gjegjësisht 100% të shpenzimeve të përgjithshme të fushatës. Përfundimisht, në zgjedhjet presidenciale në vitin 2024, katër kandidatë deklaruan pjesët e tyre të financimit publik prej 5%, 12%, 18%, dhe 97% mbi shpenzimet e fushatës së tyre.

Krahasimi i mesatareve nga 3 zgjedhjet e fundit kombëtare zbulon një prirje ku mbështetja në financimin shtetëror varet nga konteksti, me ç'rast ngjarjet e ndryshme zgjedhore tregojnë nivele të ndryshme përdorimi të fondeve publike. Zgjedhjet lokale patën varshmërinë më të larmishme, ndërsa në referendumin kushtetues u vu re një mbështetje mesatare më e lartë në fondet shtetërore. Duke pasur një varësi më të ulët në zgjedhjet presidenciale, sugjerohet se kandidatët mund të arrinin më shumë sukses në sigurimin e burimeve alternative të financimit.

Nxitja e shumëllojshmërisë më të madhe në burimet e financimit është kryesore për të përforcuar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e veprimtarive politike në Republikën e Moldavisë. Për trajtimin e këtyre çështjeve, organizatat si Promo-LEX kanë rekomanduar masa implementuese që të sigurohet ekuilibri i arsyeshëm ndërmjet financimit publik dhe privat të partive politike<sup>[11]</sup>. Ato, gjithashtu, përfaqësojnë për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe të kontrollit për të mbikëqyrur me efektivitet financimin politik dhe zgjedhor.

---

[11] Raport përmbledhës, Retrospektivë e financimit të partive politike në Republikën e Moldavisë 2023, [https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR\\_Finançare-partide-politice\\_retrospectiva-2023\\_eng.pdf](https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR_Finançare-partide-politice_retrospectiva-2023_eng.pdf)

# 5 KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE MASAT E TRANSPARENCËS

Partitë politike duhet t'i dorëzojnë në KQZ raportet e menaxhimit financiar dy herë në vit: deri më 15 korrik për gjysmën e parë të vitit dhe deri më 15 janar për gjysmën e dytë të vitit paraprak. Raporti vjetor duhet të dorëzohet deri më 31 mars.

Partitë që pranojnë ndarje fondesh duhet po ashtu t'ua dorëzojnë raportet financiare KQZ-së dhe Gjykatës së Llogarive.

Deri në datën 10-të të çdo muaji, partitë duhet t'i paraqesin në KQZ këto raporte:

- Raportin elektronik mbi shpenzimet e muajit të kaluar nga shpërndarjet.
- Raportin mujor të kuadrit mbi kuadrin e partisë

Partitë obligohen të dorëzojnë deklarata mujore bankare për periudhën e raportimit së bashku me raportin financiar. Sipas kërkesës, ato duhet t'i dorëzojnë edhe dokumentet parësore në mënyrë elektronike që mbështesin prurjet dhe shpenzimet e raportuara. Më tej, raporti mbi gjendjen pasurore të partisë duhet të përfshihet me çdo periudhë të raportuar.

Të gjitha raportet duhet të parashtrihen në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit të automatizuar "Kontrolli financiar", të firmosura nga kryetari i partisë dhe arkëtari. KQZ-ja do të njoftojë partinë pas pranimit të raportit, duke vënë datën dhe orën e parashtrimit.

KQZ-ja verifikon gjithëpërfshirjen dhe saktësinë e raporteve të parashtruara. Nëse konstatohet ndonjë problem, KQZ-ja mund të kërkojë informacion plotësues, të cilin partia duhet ta japë brenda afatit të caktuar (ose deri në 14 ditë pune). Banka ku një parti politike ka llogarinë rrjedhëse dhe/ose llogarinë për shpërndarjet e buxhetit të shtetit duhet të sigurojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, çdo gjashtë muaj dhe sipas kërkesës, me informacion për të gjitha depozitat dhe tërheqjet e kryera nga këto llogari.

Informacioni në raportet e menaxhimit financiar është publik, përveç të dhënave të ndjeshme personale. Raportet publikohen në ueb faqen zyrtare të KQZ-së brenda 48 orëve nga momenti i pranimit dhe janë në dispozicion për 5 vjet. Partitë politike, po ashtu janë të obliguara t'i publikojnë raportet në ueb faqet e tyre, nëse janë në dispozicion.

15 vjet pas pranimit të raporteve, kushdo qoftë i përfshirë në kërkime gazetareske ose shkencore mund të kërkojë qasje në këto raporte. Pas kësaj periudhe, raportet do të ruhen edhe për 15 vjet të tjera pa bashkëngjitje, pas së cilës periudhë ato do të asgjësohen. Këto kërkesa nxisin transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar të partive politike, ndërsa mbrojnë informacionin personal.

Partitë politike me prurje ose shpenzime mbi një milion lei (rreth 52.000 euro) duhet t'i kenë të revizionuara raportet e menaxhimit financiar, të paktën një herë në çdo tre vjet. Përgjegjësia për zgjedhjen e subjektit të revizionit dhe kryerjen e revizionit i takon partisë politike. Në fund të vitit 2024, KQZ-ja me mbështetjen e Këshillit të Evropës, zhvilloi një metodologji të re që të ofrojë udhëzime më të qarta për revizorët dhe të sigurojë synimin dhe përafrimine raporteve me nevojat e KQZ-së. Partia duhet të dorëzojë raportin e revizionit, së bashku me raportin financiar vjetor, në KQZ dhe, për ata që marrin fonde nga buxheti i shtetit, në Gjykatën e Llogarive. Raporti i revizionit duhet të publikohet në ueb faqen e KQZ-së brenda 48 orëve dhe të jetë në dispozicion publik për pesë vjet. Edhe partitë politike duhet ta publikojnë raportin në ueb faqen e tyre nëse kanë ndonjë të tillë.

Nëse partia nuk ka dorëzuar raportin e menaxhimit financiar ose nuk ka dhënë informacion të nevojshëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin e financimit të partisë brenda afatit dhe formatit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, veprimtaria e saj mund të kufizohet. Kufizimi i veprimtarisë së një partie politike do të thotë se partisë i ndalohet përkohësisht pjesëmarrja në zgjedhje ose referendume, përfshirja në reklamim politik, organizimi i ngjarjeve publike dhe përdorimi i llogarive të saj bankare për shumicën e transaksioneve financiare. Partia mund t'i përdorë llogaritë e saj vetëm për pagesa thelbësore, të tilla si shlyerja e kontratave, pagesa e tatimeve ose kompensimi i dëmeve.

Nëse partia nuk i dorëzon raportet vjetore të menaxhimit financiar për dy vjet radhazi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do t'i kërkojë Agjencisë së Shërbimeve Publike për ta hequr nga Regjistri Shtetëror i Subjekteve Juridike.

## **INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE DHE ORGANET MBIKËQYRËSE**

Që të sigurohet llogaridhënia e partive politike dhe përputhja e standardeve ligjore, për këtë gjë janë kompetente institucionet dhe organet mbikëqyrëse të mëposhtme:

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** ka mandat për mbikëqyrjen e financimit të partive politike dhe ndarjen e fondeve shtetërore për partitë politike. Ai zotëron dhe menaxhon një sistem specifik të automatizuar - "Kontrollin financiar", për të siguruar raportim financiar transparent dhe sistematik.

KQZ-ja ka autoritet të gjerë për:

- ✓ Projekt aktet administrative dhe dokumentet udhëzuese për zbatimin e legjislacionit financiar.
- ✓ Mbledhjen, analizimin dhe publikimin e raporteve financiare nga partitë politike, grupet nismëtare dhe konkurrentët në zgjedhje.
- ✓ Verifikimin dhe shqyrtimin e përputhjes financiare, nxjerrjen e vendimeve detyruese dhe njoftimin e gjetjeve në Parlament çdo vit.



- ✓ Bashkëpunimin me autoritetet tjera publike dhe subjektet për mbikëqyrje efektive.
- ✓ Vendosjen e sanksioneve për shkelje, duke nisur nga paralajmërimet deri në pezullimin e shpërndarjeve të buxhetit shtetëror deri në një vjet.

**Gjykata e Llogarive** pranon raporte gjysmë-vjetore dhe vjetore nga partitë politike dhe i kryen revizionet publike të jashtme<sup>[12]</sup> lidhur me shfrytëzimin e mjeteve të ndara për partitë politike.

**Ministria e Drejtësisë** mund të kërkojë nga gjyqi, ose sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që të kufizojë veprimtarinë e partisë politike dhe shpërbërjen e saj. Në rastin e likuidimit, Ministria merr pjesë në këtë procedurë.

## **KONSIDERATAT LIDHUR ME ZGJEDHJET /ME FINANCAT E FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE RAPORTIMIN**

Në fillim të periudhës zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vendos kufirin e lartë kombëtar për burimet financiare të cilat mund të transferohen në llogarinë e "Fondit zgjedhor" dhe të përdoren nga konkurrentët në zgjedhje për ato zgjedhje. Ky kufi i lartë është ekuivalent me 0.1% të prurjeve të specifikuara në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin përkatës.

Konkurrentët e zgjedhjeve duhet të hapin një llogari bankare me shenjën "Fondi zgjedhor" në afat tre ditor pas regjistrimit, duke transferuar fondet e tyre dhe donacionet e marra nga qytetarët moldavë ose subjektet vendase juridike. Për partitë politike dhe koalicionet zgjedhore, llogaria "Fondi zgjedhor" mund të hapet përpara regjistrimit. Transaksionet financiare në këtë llogari lejohen vetëm pas regjistrimit të konkurrentit, e jo përpara 30 ditëve para datës së zgjedhjeve. Pas hapjes së llogarisë "Fondi Zgjedhor", konkurrentët duhet të informojnë KQZ-në në afat 24 orësh dhe të dorëzojnë të dhënat e llogarisë. Konkurrentët që nuk hapin llogarinë në afat prej tre ditëve nga regjistrimi duhet ta njoftojnë me shkrim KQZ-në dhe mund të angazhohen vetëm në veprimtari jofinanciare të fushatës.

Banka që administron llogarinë "Fondi zgjedhor" e njofton çdo javë KQZ-në për lëvizjet financiare dhe gjendjen e llogarisë. Konkurruesit zgjedhorë duhet të caktojnë një arkëtar përgjegjës për evidencën financiare dhe dorëzimin e raporteve të nënshkruara financiare organit zgjedhor.

[12]Pavarësisht nga detyrimet e saj ligjore, Gjykata e Llogarive moldave sfidon kompetencën e saj për të kontrolluar se si partitë politike përdorin fondet publike, duke argumentuar se legjislacioni kombëtar nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Që nga fillimi i financimit të veprimtarisë së partive politike nga buxheti i shtetit, nuk është kryer asnjë kontroll i detajuar nga Gjykata e Llogarive. [https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR\\_Finançare-partide-politice\\_retrospektiva-2023\\_eng.pdf](https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR_Finançare-partide-politice_retrospektiva-2023_eng.pdf)

KQZ-ja, si organ i pavarur, mbikëqyrës dhe kontrollues, mbledh, organizon dhe verifikon raportet financiare të paraqitura nga konkurrentët në zgjedhje. Këto raporte analizohen dhe merren vendime detyruese lidhur me rezultatet e verifikimit të tyre. Konkurrentët duhet t'i dorëzojnë raportet financiare çdo javë përmes sistemit "Kontrolli financiar", ndërsa raportet përfundimtare në afat prej tre ditëve pas ditës së zgjedhjeve.

Kufijtë e donacioneve për fushatat zgjedhore janë rregulluar, me ç'rast donacionet vetjake kufizohen në gjashtë paga mesatare mujore për ekonominë në atë vit. Zbatohen kufijtë specifikë në bazë të prurjeve dhe statusit të dhuruesit, ndërsa subjektet juridike mund të dhurojnë deri në dymbëdhjetë paga mesatare mujore. Donacionet në të mirat, shërbimet dhe punën vullnetare duhet të vlerësohen dhe të njoftohen, duke respektuar kufijtë ligjorë për donacionet.

KQZ-ja përdor platformën e interoperabilitetit MConnect[13] për të verifikuar përshtatshmërinë e donatorëve dhe të sigurojë përputhjen me kufizimet ligjore. Në rastet e dyshimit për mospërputhjen me legjislacionit fiskal, KQZ-ja mund të nisë procedura kundërvajtëse ose t'ia referojë çështjen Shërbimit Tatimor Shtetëror për hetime të mëtejshme.

---

[13] Platforma e ndërveprimit MConnect është zgjidhja teknologjike e zhvilluar nga Qeveria e Republikës së Moldavisë për të thjeshtuar shkëmbimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë brenda sektorit publik, si dhe ndërmjet sektorit publik dhe privat.

# 6 MASAT E NXITJES SË PJESËMARRJES SË GRAVE DHE TË RINISË NË POLITIKË

Në Moldavi janë vendosur disa dispozita ligjore për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe të burrave në jetën politike, me masa plotësuese për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve.

Ligji për sigurimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave (Nr. 5/2006) është pjesë kryesore e legjislationit. Konkretisht, neni 7 i këtij ligji ua jep mandatin partive politike që të nxisin barazinë e të drejtave dhe të mundësive në mesin e anëtarëve të tyre. Për ta arritur këtë, partitë politike duhet t'i përmbahen kuotës minimale të përfaqësimit gjinor prej 40% për të dyja gjinitë në organet e tyre drejtuese dhe listat e kandidatëve, duke siguruar përfaqësim të balancuar gjinor pa diskriminim.

Ligji për partitë politike (No. 294/2007) dhe Kodi Zgjedhor ofrojnë disa masa pozitive për të mbështetur barazinë gjinore, duke përfshirë si më poshtë:

- 1.** Kuotën e dyfishtë gjinore për listat e kandidatëve: Listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare dhe lokale duhet të respektojnë kuotën minimale të përfaqësimit prej 40% për të dyja gjinitë. Pozicionimi i kandidatëve në lista ndjek një rregull: të paktën katër kandidatë për çdo dhjetë pozicione duhet të jenë të secilës gjini.[14]
- 2.** Sanksionet për mosrespektim: Nëse një parti politike paraqet një listë kandidatësh që nuk plotëson kërkesat e kuotës gjinore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose këshilli zgjedhor i rrethit do të refuzojë regjistrimin e saj.
- 3.** Mbrojtjen ligjore kundër shtrembërimit të kuotave: Partitë politike ose koalicionet zgjedhore duhet të sigurojnë që çdo ndryshim në listat e tyre të kandidatëve duhet të respektojë kuotat gjinore të përshkruara me ligj. Konkretisht, çdo tërheqje ose modifikim i listës së kandidatëve duhet të bëhet nga partia ose koalicioni që e ka paraqitur atë, duke siguruar që të ruhet përqindja minimale e kandidateve femra, siç kërkohet me ligj.
- 4.** Kërkesa e reduktuar për nënshkrime për kandidatet e pavarura femra: Kandidatet e pavarura femra duhet të dorëzojnë vetëm 1000 deri në 2500 nënshkrime nga mbështetësit me të drejtë vote (krahasuar me 2000-2500 nënshkrime të nevojshme për kandidatët meshkuj) për t'u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (për zgjedhjet parlamentare)

[14] Neni 68, paragrafi (3) i Kodit Zgjedhor

**5.** Stimujt financiarë për gratë e zgjedhura: 7.5% e fondeve vjetore shtetërore që ndahen për partitë politike shpërndahet proporcionalisht në bazë të numrit të grave të zgjedhura në zgjedhjet parlamentare, dhe 7.5% tjetër ndahet në bazë të numrit të grave të zgjedhura në zgjedhjet lokale.

**6.** Financimi për iniciativat për barazi gjinore: 20% e ndarjeve vjetore shtetërore për partitë politike duhet të përdoren për të promovuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe zgjedhore.[15]

**7.** Mbështetje për organizatat e grave në parti politike: Në partitë me organizata të grave, fondet e caktuara për promovimin e pjesëmarrjes së grave menaxhohen nga këto organizata.

Sanksionet për shpërdorim fondesh: Nëse fondet nuk përdoren për qëllimet e përcaktuara, duhet t'i kthehen buxhetit të shtetit, sipas vendimit të Gjykatës së Llogarive, në bazë të shumës së përdorur në mënyrë të gabuar.

Ligji për partitë politike përfshin gjithashtu dispozita që mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfaqësimin politik. Masat kryesore përfshijnë:

**1.** Stimujt financiarë për të rinjtë e zgjedhur: 5% e financimit vjetor shtetëror dedikuar partitëve politike ndahen proporcionalisht në bazë të numrit të të rinjve të zgjedhur në zgjedhjet parlamentare dhe 5% -shi tjetër ndahet për të zgjedhurit në zgjedhjet lokale.

**2.** Fondet për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve: 10% e shumës së fondeve të ndara për partitë politike duhet të përdoren për të nxitur dhe inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset politike dhe zgjedhore.

**3.** Mbështetja e organizatave rinore në parti politike: Për partitë politike me organizata rinore, fondet e caktuara për promovimin e pjesëmarrjes rinore menaxhohen nga këto organizata.

**4.** Sanksionet për shpërdorim fondesh: Ashtu si fondet për pjesëmarrjen e grave, nëse fondet për angazhimin e të rinjve përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të specifikuara, duhet t'i kthehen buxhetit të shtetit, siç përcaktohet nga Gjykata e Llogarive.

---

[15] Ligji nuk specifikon ndonjë kërkesë të veçantë për promovimin e grave dhe rinisë në suaza të fondeve të shpërndara për fushatat zgjedhore.

## KONSIDERATAT LIDHUR ME NDIKIMIN E MASAVE LIGJORE PËR NXITJEN E PJESËMARRJES SË GRAVE DHE RINISË NË POLITIKË

Evoluimi i përfaqësimit të grave në parlamentin moldav nga viti 1990 deri në vitin 2021 pasqyron ndikimin e ndryshimeve të sistemit zgjedhor dhe kuotave gjinore në promovimin e barazisë gjinore në politikë (Shih Tabelën 1).

Në vitet e para (1990-1994), gratë ishin dukshëm të nënpërfaqësuara, me vetëm 3.8% në 1990 dhe me një rritje të pakët në 4.9% në 1994. Futja e sistemit të përfaqësimit proporcional nga viti 1994 deri në vitin 2014 fillimisht nuk çoi në përmirësime thelbësore, pasi që përqindja e grave mbeti e ulët, duke arritur kulmin në 25.7% në v. 2009 përpara se të binte pak në vitet e mëvonshme.

Një ndryshim i dukshëm ndodhi pas zbatimit të kuotave gjinore dhe stimuljeve financiarë që synonin rritjen e pjesëmarrjes së grave. Në zgjedhjet e v. 2019 u vu kuota gjinore prej 40%, megjithëse kjo u zbatua vetëm për komponentin proporcional, për shkak të sistemit aktual zgjedhor të përzier paralel. Me këtë u stabilizua përfaqësimi i grave në 25.7%, që tregon se kuota ka pasur njëfarë efekti pozitiv, megjithëse të kufizuar nga sistemi i përzier.

**Tabela 1. Gratë në Parlamentin e Moldavisë (1990 – 2021) <sup>16</sup>**

Zgjedhjet <sup>17</sup>	Gjithsej deputetë	Gra	%
1990	380	12	3,8
1994	101	5	4,9
1998	101	9	8,9
2001	101	16	15,8
2005	101	21	20,8
2009	101	26	25,7
2010	101	19	18,8
2014	101	21	20,9
2019	101	26	25,7 <sup>18</sup>
2021	101	40	39,6

Njësitë zgjedhore me një mandat. Asnjë kuotë gjinore.

Sistemi i përfaqësimit proporcional. Asnjë kuotë gjinore.

Kuota gjinore 40% u fut në vitin 2016, por menjëherë pas kësaj u zbatua një sistem i ri zgjedhor i përzier paralel. Kuota zbatohet vetëm për komponentin proporcional, ndërkohë që u vendosën stimuj financiarë për komponentin e shumicës në njësitë zgjedhore njëmandatëshe për të mbështetur pjesëmarrjen e grave. Këto ishin zgjedhjet e vetme që përdorën sistemin e përzier.

Sistemi i përfaqësimit proporcional. Kuota e dyfishtë gjinore dhe stimujt financiarë, siç përshkruhen në kapitullin *Masat për promovimin e pjesëmarrjes politike të grave dhe të rinjve*.

[16] Burimi: [www.cec.md](http://www.cec.md)

[17] Zgjedhjet e ardhme parlamentare janë planifikuar për v. 2025


[18] Për Zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, listat e kandidatëve kërkohej t'i përmbaheshin 40% të kuotës së përfaqësimit gjinor për të dyja gjinitë. Partitë politike që plotësuan kuotën e të paktën 40% të kandidatëve femra në njësitë zgjedhore me një mandat morën rritje prej 10% në mbështetjen buxhetore. Gjithashtu, 5% e fondeve u ndanë në bazë të numrit të grave të zgjedhura në parlament dhe numrit të të rinjve të zgjedhur në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Neni 42 paragrafi (21) dhe (22), versioni i Kodit Zgjedhor 2017 dhe neni 27, Ligji për partitë politike, versioni 2018.

Përmirësimi më domethënës erdhi me zgjedhjet e vitit 2021, ku u prezantua kuota e dyfishtë gjinore së bashku me stimujt financiarë për të promovuar pjesëmarrjen e grave në politikë. Kjo rezultoi në një rritje të konsiderueshme të përqindjes së grave në Parlament, duke arritur në 39.6%. Kjo rritje e menjëhershme nënvizon efektivitetin e kombinimit të kuotave me stimujt financiarë në rritjen e përfaqësimit të grave. Tregon rëndësinë e masave të qëndrueshme dhe të synuara për arritjen e barazisë gjinore në institucionet politike.

Në vitin 2018, në Ligjin për Partitë Politike u futën masa pozitive për inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve. Fillimisht, 5% e shpërndarjeve të buxhetit të shtetit iu shpërndanë partive politike bazuar në numrin e të rinjve të zgjedhur efektivisht në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.

Në vitin 2019, kjo ndarje u zgjerua në 5% për të rinjtë e zgjedhur si në zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe në ato lokale. Më tej, reformat e vitit 2019 vendosën kërkesën që 10% e ndarjeve vjetore të buxhetit të shtetit të përdoret veçanërisht për promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politike dhe zgjedhore.

Përfaqësimi i të rinjve në Parlamentin e Moldavisë nga viti 1994 deri në vitin 2021, ilustron sfidat dhe përmirësimet graduale në pjesëmarrjen e të rinjve në politikë (Shih tabelën 2).



[19] Zgjedhjet e ardhme parlamentare janë planifikuar për v. 2025

Në vitet e para (1994-2005), përfaqësimi i të rinjve luhatej në nivele të ulëta, me një rënie të dukshme nga 10,89% në 1994 në vetëm 1,98% në 2001. Mungesa e dispozitave specifike ose stimujve për pjesëmarrjen e të rinjve gjatë kësaj periudhe ka kontribuar me gjasë në këto numra të ulët.

Pikë kthesë u bë në zgjedhjet e vitit 2009, ku përfaqësimi i të rinjve filloi të rritet, duke arritur në 7,92%, dhe vazhdoi të rritet, duke arritur kulmin në 15,84% në 2019. Kjo rritje përkoji me futjen e stimujve financiarë për të rinjtë që u zgjodhën efektivisht gjatë zgjedhjeve me sistem të përzier zgjedhor në v.2019. Ky sistem, i cili kombinonte komponentët proporcionalë dhe të shumicës, ofroi mbështetjen e parë për pjesëmarrjen e të rinjve, duke sugjeruar se stimujt financiarë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në inkurajimin e të rinjve për të kandiduar për poste dhe për të pasur sukses.

Në vitin 2021, me kthimin në sistemin e përfaqësimit proporcional dhe zbatimin e stimujve financiarë dhe rregullave për ndarjen e shpenzimeve shtetërore për promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve, përqindja e deputetëve të rinj mbeti relativisht e lartë në 13,86%. Kjo tregon se këto masa kanë pasur një ndikim pozitiv, megjithëse ka ende vend për përmirësime të mëtejshme.

Edhe pse përfaqësimi i të rinjve në parlamentin moldav është rritur përgjithësisht gjatë viteve, ai mbetet nën nivelet e dëshiruara.

### ***KONSIDERATAT NË LIDHJE ME RESPEKTIMIN E KËRKESAVE LIGJORE NGA PARTITË POLITIKE PËR NDARJEN E FONDEVE PËR NXITJEN E PJESËMARRJES SË GRAVE DHE RINISË***

Siç u përmend më lart, partive u kërkohet ligjërisht të ndajnë 20% të fondeve shtetërore për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe 10% për pjesëmarrjen e të rinjve. KQZ shqyrton raportet financiare të paraqitura nga partitë politike për të siguruar respektimin e këtyre kufijve ligjorë.

Në rastet kur partitë raportojnë shpenzime nën përqindjet e kërkuara ose nuk arrijnë të ndajnë fonde për qëllimet e përcaktuara, KQZ-ja identifikon mospërputhje, duke përfshirë fondet e papërdorura ose bilancet negative në krahasim me ndarjet e planifikuara. Për shembull, në vitin 2023, dhjetë parti shpenzuan më pak për pjesëmarrjen e grave, ndërsa tetë për pjesëmarrjen e të rinjve, ndërsa pesë parti që raportuan zero shpenzime për të dyja kategoritë. Kur konstatohen mospërputhje të tilla, KQZ-ja heton arsyet e tyre dhe merr masa korigjuese.

Në vitin 2023, KQZ-ja nisi procedimet kundërvajtëse ndaj disa partive politike për shpërdorim fondesh. Kjo nxjerr në pah angazhimin e KQZ-së për të zbatuar rregulloret financiare dhe për të siguruar që shpërndarjet shtetërore po përdoren për qëllimet e dhëna. Këto përpjekje kanë për synim që të sigurojnë se partitë politike i respektojnë kërkesat ligjore për të nxitur përfaqësim politik më gjithëpërfshirës.

Shkalla mesatare e pajtueshmërisë sugjeron se shumë parti politike nuk arrijnë të përmbushin pragjet ligjore. Për pjesëmarrjen e grave, vetëm në vitin 2023 partitë shpenzuan mesatarisht 12.16%, që është pak më shumë se gjysma e shumës së përcaktuar me ligj. Në mënyrë të ngjashme, për pjesëmarrjen e të rinjve, kërkesa ligjore është 10%, por partitë kanë ndarë mesatarisht vetëm 6.90%, përsëri rreth 60-70% të përqindjes së kërkuar. Është e rëndësishme të theksohet se këto fonde të pashpenzuara do mund të përdoren vitin e ardhshëm fiskal. Partitë politike duhet të sigurojnë se ato do t'i përdorin fondet në bazë të qëllimit fillestar, ose do të përballen me ndëshkime për përdorimin e fondeve për qëllime tjera.

Edhe pse disa parti tejkaluan shpërndarjet e kërkuara si në vitin 2022, ashtu edhe në vitin 2023, tendenca e përgjithshme pasqyron shfrytëzimin jo aq të madh, duke theksuar nevojën për zbatim më të fortë dhe respektim më të mirë të këtyre detyrimeve ligjore. Mospërputhja midis shpenzimeve të pritshme dhe atyre aktuale nënvizon rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm nga ana e KQZ-së për të siguruar që fondet shtetërore po përdoren në mënyrë efektive për të promovuar barazinë gjinore dhe përfshirjen e të rinjve në proceset politike.

Në raportet e tyre të vitit 2022 dhe 2023, Shoqata Promo-Lex, një organizatë joqeveritare që monitoron financimin e partive politike në Republikën e Moldavisë, i rekomandoi KQZ-së që të miratojë një udhëzues të detajuar sesi duhet të jenë shpenzimet e programeve për të rinjtë dhe gratë për raportim. Në fakt një udhëzues i tillë është zhvilluar, por aktualisht konsiderohet vetëm si rekomandim dhe nuk është publikuar në faqen e KQZ-së. KQZ-ja i përdor këto udhëzime gjatë trajnimit të thesareve të partive politike.



# 7

## SFIDAT KRYESORE NË FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

Korniza juridike për financimin e partive politike në Moldavi promovon transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje. Përmes ndarjeve shtetërore, kërkesave të sakta të raportimit, dhe masave të nxitjes së pjesëmarrjes së grave dhe të rinisë, Moldavia ka shënuar një përparim të madh. Megjithatë, disa sfida vazhdojnë së ekzistuari:

- ◆ Kapaciteti dhe mbikëqyrja e KQZ-së: Pa marrë parasysh formimin e departamentit të posaçëm për mbikëqyrjen e financimit të partive dhe të fushatave zgjedhore, KQZ-ja përballet me kufizime të kapacitetit në zbatimin e plotë të transparencës. Përderisa platforma „MConnect” ka përmirësuar shkëmbimin e të dhënave, KQZ-ja kërkon më shumë burime dhe ekspertizë teknike për të shtuar mbikëqyrjen e saj. Sistemi i “Kontrollit financiar” për raportim elektronik financiar, po ashtu ka nevojë për përmirësime.
- ◆ Ekuilibrimi i financimit publik dhe privat: Moldavia duhet të sigurojë një ekuilibër më të mirë ndërmjet financimit publik dhe privat të partive politike për të ruajtur integritetin publik.
- ◆ Verifikimi fondeve për pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve: Kërkesat ligjore për partitë politike për të menaxhuar fondet për pjesëmarrje gjinore dhe rinore përmes organizatave të dedikuara në kuadër të partisë janë vështirë për t’u verifikuar. Edhe pse disa parti mund të kenë edhe nën-llogari për këto fonde, raportet tregojnë se fondet zakonisht i menaxhojnë në mënyrë qendrore. Korniza juridike kërkon njoftimin e shpenzimeve, por jo detyrimisht kërkon detaje për mënyrën e menaxhimit të fondeve. Shkalla e ulët e shfrytëzimit të fondeve gjinore dhe rinore sugjeron nevojën e udhëzimit ose monitorimit më të mirë për të siguruar përdorimin e plotë dhe efektiv.
- ◆ Përfshirja e palëve të treta në fushata: Korniza juridike e Moldavisë për rregullimin e përfshirjes së palëve të treta në fushatat zgjedhore nuk është aq e zhvilluar, duke shtuar rrezikun e ndërhyrjeve keqbërëse dhe rrënimin e transparencës zgjedhore, siç është theksuar nga GRECO dhe ODIHR.

- ◆ Çështjet e raportimit financiar: Raportimi në kohë dhe i saktë financiar mbetet një sfidë. Disa parti dhe kandidatë nuk ia dalin të dorëzojnë raporte të plota, përfshirë mosparaqitjen e fondeve dhe mospublikimin e pagesave. KQZ ka nisur procedimet kundërvajtëse, por problemi i përpunimit të kontributeve bankare vazhdon të vonojë përmbushjen e kërkesave të raportimit.
- ◆ Qasja e Gjykatës së Llogarive: Gjykata e Llogarive të Moldavisë sfidon autoritetin e vet që të bëjë revizion se si partitë politike i përdorin fondet publike, pavarësisht mandatit të saj ligjor, duke vënë në dukje mospërputhjet me standardet ndërkombëtare të revizionit.

Këto sfida sfidojnë nevojën për përmirësime në kornizën ligjore dhe kapacitetin operativ të institucioneve të përfshira në financimin e partive politike. Trajtimi i tyre do të shtonte transparencën dhe llogaridhënien në financimin e partive politike të Moldavisë.

Ndarja – shuma e burimeve financiare të miratuara në buxhetin e shtetit për financimin e partive politike.

Paga mesatare ekonomike – shuma e miratuar me Vendim të Qeverisë për përdorim të përcaktuar me ligj.

Donacionet – burime monetare, të mira materiale/jo materiale, ose shërbime të ofruara në mënyrë vullnetare dhe pa kushte për një parti politike dhe të pranuar prej saj.

Financimi i fushatës zgjedhore – mbulon mbështetjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfshirë veprimet në bazë vullnetare dhe shërbimet e ofruara pa pagesë nga individët ose subjektet për konkurrentët në zgjedhje dhe pjesëmarrësit në referendum.

Grupet iniciative – rregulla të ngjashme për financim zbatohen për grupet iniciative, duke përfshirë mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, veprimet vullnetare dhe kontributet materiale.

Tarifë anëtarësimi - një shumë fikse e paguar periodikisht nga anëtarët e një shoqate ose organizate.

Parti - shoqatat vullnetare, me statusin e subjekteve juridike, të shtetasve të Republikës së Moldavisë me të drejta zgjedhore, të cilët, me veprimtari të përbashkëta dhe në bazë të parimit të pjesëmarrjes së lirë, kontribuojnë në formulimin, shprehjen dhe realizimin e vullnetit të tyre politik.

Mjetet e partisë – tituj pronash për objektet, pajisjet, shtëpitë botuese, shtypshkronjat, mjetet e transportit, dhe mjetet e tjera të partisë të lejuara ligjërisht.

Financimi i partive politike – përfshin kontributet financiare dhe materiale, veprime në bazë vullnetare dhe shërbime pa pagesë, si dhe ndarje të fondeve shtetërore.

Arkëtar – person përgjegjës për financat e partisë politike, konkurrent në zgjedhje, pjesëmarrës në referendum ose në një grup iniciativ.

Programi i grave/rinisë – Një sërë masash dhe aktivitete të strukturuar me miratim ose me pëlqim të organit vendimmarrës të partisë politike, nëpërmjet të cilave planifikohen dhe kryhen aktivitete ose veprime për përfshirje, promovim dhe inkurajim të pjesëmarrjes së grave/rinisë në procese vendimmarrëse dhe politike. Këto synojnë, por nuk kufizohen në: kompensimin, zhvillimin e shkathtësive personale dhe profesionale, forcimin e organizatave të grave/të rinisë, rritjen e qasjes në vendime dhe burime të brendshme, pjesëmarrjen në vendimmarrjet e brendshme dhe avancimin në poste të brendshme dhe të zgjedhura në shkallë kombëtare.

## #2 KORNIZA TË HOLLËSISHME LIGJORE DHE RREGULLUESE PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE NË MOLDAVI

Korniza juridike lidhur me financimin e partive politike në Moldavi përfshin:

- ▶ Kodin Zgjedhor (Nr. 325/2022)
- ▶ Ligjin për Partitë Politike (Nr. 294/2007)
- ▶ Kodin Kundërvajtës (Nr. 218/2008)
- ▶ Kodin Penal (Nr. 985/2002)
- ▶ Rregulloren për financimin e aktiviteteve të partive politike (me pëlqim të vendimit të KQZ-së Nr. 1102/2023)
  
- ▶ Rregulloren për financimin e grupeve iniciative dhe fushatave zgjedhore (me pëlqim të Vendimit të KQZ-së Nr. 1185/2023)

Ligji për partitë politike<sup>[20]</sup> (Nr. 294/2007) vendos kornizën rregulluese për partitë politike në Moldavi, duke adresuar financimin, llogaridhënien dhe transparencën. Përshkruan mbështetjen shtetërore, ndalon financimin e huaj dhe anonim dhe vendos kufizimet e donacioneve. Partitë duhet të dorëzojnë raporte financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i cili mbikëqyr respektimin dhe zbaton sanksionet për shkeljet. Ndarjet e buxhetit të shtetit shpërndahen në bazë të rezultateve zgjedhore, gjinisë dhe përfaqësimit të të rinjve. Partitë mund të realizojnë të ardhura të ligjshme, por përballen me ndëshkime, duke përfshirë çregjistrimin, për mospëlqim.

Kodi zgjedhor<sup>[21]</sup> (Nr. 325/2022) dispozitat trajtojnë plotësisht financimin politik dhe të fushatës, duke theksuar transparencën, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e pavarur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve <sup>[22]</sup> (KQZ).

Kodi Kundërvajtës<sup>[23]</sup> mbron rregullat për menaxhimin financiar në partitë politike, fondet zgjedhore dhe grupet iniciative, duke trajtuar shkeljet, si p.sh.:

- 1.** Mosdorëzimi ose falsifikimi i raporteve financiare.
- 2.** Keqmenaxhimi ose keqpërdorimi i mjeteve dhe fondeve, përfshirë ndarjet shtetërore.
- 3.** Përdorimi i paligjshëm i burimeve administrative në zgjedhje.
- 4.** Praktikë të paautorizuara financiare si tejkalimi i kufijve të donacioneve ose kontributet anonime.

[20] [https://www.legis.md/cautare/getResults?doc\\_id=141459&lang=ro#](https://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=141459&lang=ro#)

[21] [https://www.legis.md/cautare/getResults?doc\\_id=144550&lang=ro#](https://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=144550&lang=ro#)

[22] Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një autoritet publik i pavarur dhe jopolitik i ngarkuar me zbatimin e politikave zgjedhore, sigurimin e organizimit të zgjedhjeve dhe mbikëqyrjen e respektimit të ligjeve për financimin e partive politike dhe fushatave.

[23] [https://www.legis.md/cautare/getResults?doc\\_id=136631&lang=ro#](https://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=136631&lang=ro#), Nenet 481-483

Ndëshkimet për shkeljet e rregulloreve të menaxhimit financiar për partitë politike, fondet zgjedhore dhe grupet iniciative zbatohen ndaj individëve në pozicionet me përgjegjësi dhe/ose subjekteve juridike. Këto gjopa përfshijnë paralajmërime ose gjopa që lëvizin nga 60 deri në 600 njësi konvencionale[24], në varësi të natyrës dhe ashpërsisë së shkeljes, dhe mund të përfshijnë heqjen e disa të drejtave ose funksioneve për një periudhë nga 3 muaj deri në 1 vjet në rastet që përfshijnë keqpërdorim të fondeve shtetërore. apo burime të paligjshme zgjedhore.

Kodi Penal[25] kap vepra më të rënda (p.sh. falsifikimin, zhvatjen dhe financimin kriminal) me dënime më të ashpra për veprat penale të financimit politik që i përfshijnë edhe ndëshkimet financiare edhe kufizimet e të drejtave. Përcakton dënime për:

1. Falsifikimin e raporteve financiare për të fshehur identitetet e donatorëve, për të shtrembëruar fondet ose për keqpërdorim të burimeve të padeklaruarra/të huaja në sasi të mëdha,
2. Përdorimi i paligjshëm i burimeve administrative gjatë zgjedhjeve duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.
3. Detyrimi i individëve që të japin donacione për partitë politike apo për fondet zgjedhore.
4. Keqpërdorimi i ndarjeve të buxhetit të shtetit apo fondeve zgjedhore duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.
5. Pranimi i vetëdijshtëm i financimeve nga grupet e krimit të organizuar ose organizatat kriminale.
6. Financimi i partive politike, grupeve iniciative ose fushatave zgjedhore nga burime të ndaluara në shuma të konsiderueshme.

**Rregullorja për financimin e aktiviteteve të partive politike**[26] (me pëlqim të Vendimit të KQZ-së Nr. 1102/2023) përcakton kushtet dhe procedurat për mbështetjen financiare të aktiviteteve të partive politike, procesin e dorëzimit të raporteve të menaxhimit financiar, mbikëqyrjen dhe kontrollin e financimit të partive politike, si dhe përgjegjësinë për shkeljen e legjislacionit në fushën e financimit të partive politike..

**Rregullorja për financimin e grupeve iniciative dhe fushatave zgjedhore**[27] (me pëlqim të Vendimit të KQZ-së Nr. 1185/2023) përcakton kushtet dhe procedurat e mbështetjes financiare të aktiviteteve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidatëve për postet e zgjedhura publike dhe fushatat zgjedhore të konkurrentëve në zgjedhje, procedurat për paraqitjen e raporteve për financimin e grupeve iniciative dhe fushatat zgjedhore, mbikëqyrjen dhe kontrollin e financimit të grupeve iniciative dhe konkurrentëve në zgjedhje/pjesëmarrësve në referendum, si dhe përgjegjësinë për shkeljen e legjislacionit në fushën e financimit të grupeve iniciative dhe fushatat zgjedhore.

[24] [https://www.legis.md/cautare/getResults?doc\\_id=143535&lang=ro#](https://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=143535&lang=ro#), Nenet 181<sup>2</sup> dhe 181<sup>3</sup>

[25] [https://a.cec.md/storage/ckfinder/files/Regulament\\_finantarea%20aktivit%20partidelor%20politice.pdf](https://a.cec.md/storage/ckfinder/files/Regulament_finantarea%20aktivit%20partidelor%20politice.pdf)

[26] <https://a.cec.md/storage/ckfinder/files/Regulament%20finantare%20GI%20si%20campanii%20electorale.pdf>

### #3 REFERENCAT

1. Kodi zgjedhor Nr.325/2022
2. Kodi zgjedhor Nr.1381/1997
3. Ligji për partitë politike Nr.294/2007
4. Ligji për sigurimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave (Nr. 5/2006)
5. Kodi kundërvajtës (Nr. 218/2008)
6. Kodi penal (Nr. 985/2002)
7. Rregullore për financimin e aktiviteteve të partive politike (me pëlqim të Vendimit të KQZ-së Nr. 1102/2023)
8. Rregullore për financimin e grupeve nismëtare dhe fushatave zgjedhore (me pëlqim të Vendimit të KQZ-së Nr. 1185/2023)
9. Vendimi i KQZ-së për miratimin e mendimit për projektligjin për ndryshimin e disa akteve normative (luftimi efektiv i korrupsionit zgjedhor dhe aspekteve që lidhen me të), nisma legislative nr. 381 më 17 dhjetor, 2024
10. Moldavia ndërmerr hapin historik për të promovuar barazinë gjinore në politikë, <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2016/06/moldova-takes-historic-step-to-promote-gender-equality-in-politics>
11. Financimi i partive politike në Republikën e Moldavisë. Raporti përmbledhës: Retrospektivë 2022, [https://promolex.md/wp-content/uploads/2023/06/SUMAR\\_ENGL\\_Finançare-partide-politice.pdf](https://promolex.md/wp-content/uploads/2023/06/SUMAR_ENGL_Finançare-partide-politice.pdf)
12. Financimi i partive politike në Republikën e Moldavisë. Raporti përmbledhës: Retrospektivë 2023, [https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR\\_Finançare-partide-politice\\_retrospectiva-2023\\_eng.pdf](https://promolex.md/wp-content/uploads/2024/06/SUMAR_Finançare-partide-politice_retrospectiva-2023_eng.pdf)
13. Vendimi i KQZ-së për ushtrimin e autoritetit të mbikëqyrjes së raporteve për menaxhimin financiar të partive politike për vitin 2022. (Nr. 1092/2023)
14. Vendimi i KQZ-së për ushtrimin e autoritetit të mbikëqyrjes së raporteve për menaxhimin financiar të partive politike për vitin 2023. (Nr. 2560/2024)
15. Raportet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rezultatet e Zgjedhjeve Presidenciale të Republikës së Moldavisë (2024), të Referendumit Kushtetues (2024) dhe të Zgjedhjeve të Përgjithshme Vendore (2023) (miratuar me Vendimet e KQZ-së nr. 3209/2024, 3147/ 2024 respektivisht 2355/2024)
16. Komiteti i Pavarur Këshillimor Kundër Korrupsionit, Raporti i Progresit Nr.1 për Raportin Nr.3: Paratë që fitojnë zgjedhjet. Financimi politik dhe i fushatave në Moldavi, gusht 2024. [Изборен законик \(бр. 325/2022\)](#).